



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. S2S4 Prot.

Dt. 10.07.2026

PROJEKT-VENDIM

NR ____ . DATE 10.07.2026

PËR

“MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.46, DATË 16.06.2018, “PËR QERADHËNIEN E ZYRAVE PÛRKATËSE TË BASHKISË ROSKOVEC”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1 dhe nënpika 1.2 shkronja “a”, neni 54 shkronja “e/1” të ndryshuar, ligjit nr 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” si edhe kërkesës datë 20.05.2026 nga organizata “Gruaja Komuniteti Mjedisit CWE-HD” depozituar pranë protokollit të Bashkisë Roskovec me Nr 3728 prot, datë 20.05.2026,

Ju paraqesim për diskutim e miratim,

1-Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.46, datë 16.06.2018, “Për qeradhëniën e zyrave përkatëse të Bashkisë Roskovec”, konkretisht : pika 1 e vendimit ndryshohet në :

“1” - “Dhënie në përdorim të një sipërfaqe 33m2 në godinën e pallatit të Kulturës Roskovec, Organizatës jo fitimprurëse Gruaja Komuniteti Mjedisit CWE-HD, për ushtrim të aktiviteteve jofitimprurëse komunitare e artizane, sipas plan vendosjes dhe dokumentave të pronësisë bashkëlidhur .

2-Pas miratimit ngarkohet Sektori i Menaxhimit të pronave dhe Sektori i Integrimit Europian për ndjekje dhe zbatim .

Konceptoi: N. Pelivani 

Për drejtorinë juridike : V. Zeqo 

KRYETAR
Majlinda Buqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 884/1 prot

Roskovec, më 10.07.2026

Lënda: Relacion shpjegues mbi një ndryshim në vendimin Nr 46, datë 16.06.2018, “Për qeradhënien e zyrave përkatëse të Bashkisë Roskovec”

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec,

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, konkretisht neni 9, pika 1.2: Të drejtat dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë, nenit 54: Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, pika e/1: Miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës dhe aseteve publike në funksion të interesit komunitar dhe zhvillimit lokal, ligjit nr 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe kërkesës së depozituar pranë protokollit të Bashkisë Roskovec nga Organizata lokale “Gruaja Komunitet Mjedisi” me Nr 3728, datë 20.05.2026 :

J’u paraqesim për miratim kërkesën për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak me Nr 46, datë 16.06.2018, “Për qeradhënien e zyrave përkatëse të Bashkisë Roskovec”,

Konkretisht : pika 1 e vendimit ndryshohet në : “Dhënie në përdorim të një sipërfaqe 33m2 në godinën e pallatit të Kulturës Roskovec, sipas dokumentave bashkëlidhur, Organizatës jo fitimprurëse Gruaja Komuniteti Mjedisi CWE-HD, si zyrë dhe hapësirë për ushtrim të aktiviteteve jofitimprurëse komunitare e artizane .

Referuar kërkesës së OJF-së “ Gruaja Komuniteti Mjedisi CWE-HD, drejtuar Bashkisë Roskovec me Nr prot 3728, datë 20.05.2026 dhe vendimit ekzistues të Këshillit Bashkiak OJF-së i është vënë në dispozicion një ambient me sipërfaqe prej vetëm 6m2 si ambient për zyrë.

Në kushtet e rritjes së pjesëmarrjes dhe zgjerimit të iniciativave komunitare e kulturore të zbatuara nga Organizata është krijuar nevoja për një hapësirë më funksionale dhe me kapacitet më të madh, e cila mund të përdoret edhe për ofrimin e kurseve të formimit profesional për gratë dhe vajzat

Kjo hapësirë do të shërbejë jo vetëm si zyrë funksionale për organizatën, por edhe si një pikë takimi, bashkëpunimi dhe promovimi për gratë artizane, të cilat kanë nevojë për mbështetje dhe ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tyre në ruajtjen e traditave lokale.

Aktivitet ky i cili vitet e fundit ka marrë një dimension më të gjerë social dhe promovues për territorin e Roskovecit, duke shërbyer si një vlerë identitare për të cilën po punohet edhe në nivel kombëtar për tu futur në listën e UNESCO dhe si një shembull i angazhimit të grave në jetën ekonomike dhe komunitare. Në këtë kuadër, mbështetja institucionale përmes sigurimit të një ambienti funksional dhe të përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit përbën jo vetëm një detyrim në funksion të interesit publik lokal, por edhe një akt mbështetjeje njerëzore dhe sociale në ruajtjen e traditës dhe zhvillimin e komunitetit.


Ndryshimi i vendimit të mëparshëm nuk cenon interesin publik, përkundrazi krijon mundësi më të mira për:

- zhvillimin dhe formalizimin e mëtejshëm të aktivitetit artizanal;
- promovimin e trashëgimisë kulturore dhe identitetit lokal;
- organizimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe promovuese;
- fuqizimin ekonomik të grave dhe rritjen e përfshirjes së tyre në jetën publike;
- Kthimin e këtij ambienti në një pikë promovimi për produktet dhe vlerat e territorit të Roskovecit.

Në përfundim, në mbështetje të bazës ligjore të sipërcituar, propozojmë miratimin nga Këshilli Bashkiak i ndryshimit të Vendimit të mëparshëm, duke zëvendësuar ambientin aktual me një ambient më të përshtatshëm dhe funksional për ushtrimin e aktivitetit të organizatës, në përputhje me interesin publik dhe zhvillimin social-ekonomik të komunitetit lokal.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Konceptoi: N. Pelivani



KRYETAR
Majlinda Bufi